

VENDIM
Nr. 22, datë 13.1.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË NDËRTESAVE QË
PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMI I PIKËS SË AKSESIT, PËR
INFRASTRUKTURËN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 20, të ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kategorive të ndërtesave që përjashtohen nga detyrimi për të pasur pikë aksesit në godinë, për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen autoritetet planifikuese qendrore dhe vendore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Shtojca nr. 1

**KATEGORITË E NDËRTESAVE QË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMI PËR
PIKËN E AKSESIT, PËR INFRASTRUKTURËN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE**

Kategoritë e ndërtesave që përjashtohen nga detyrimi për të pasur pikë aksesit në godinë, për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike janë, si më poshtë vijon:

1. Ndërtesat në përdorim të Ministrisë së Mbrotjes dhe/ose forcave ushtarake, ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, portet, aeroportet, si dhe godinat në përdorim për qëllime të sigurisë kombëtare;

2. Ndërtesat që përfshihen në listën e monumenteve kulturore apo që ndodhen në qendra, në zona dhe në parqe arkeologjike, në zona të mbrojtura në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, kur ndërtimi i pikës së aksesit në godinë mund të ndryshojë në mënyrë të papranueshme karakterin ose pamjen e tyre;

3. Ndërtesa në zona të izoluar e të largëta, ku perspektiva për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë nuk e justifikon pajisjen e godinës me infrastrukturë fizike të gatshme për komunikime elektronike me shpejtësi të lartë ose me një pikë aksesit;

4. Ndërtesa që shërbejnë si hangarë, stalla, pulari, sera bujqësore, garazhe, magazina apo godina të vogla të shërbimeve, që nuk sigurojnë shërbime të fjetjes;

5. Përjashtimi për ndërtesat e përmendura në pikën 2, të kësaj shtojce, do të aplikohet edhe në rastet e miratimit të lejeve për punime të rikonstruksioneve, të restaurimeve në një godinë biznesi apo banimi, kur investimi për pikën e aksesit në godinë është i lartë dhe nuk justifikohet kundrejt totalit të investimeve për punimet e rinovimit e nuk përbën përfitim shtesë për individin apo për bashkëpronarët e ndërtesës.